



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 gusht 2021

Gjuha në origjinal: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar:
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:
Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave:
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit:
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:
Venkatesvari Alagendra

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Veseli për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve për apelin e ardhshëm të tij kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi mocionet paraprake që ngrenë kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara (përkatësisht, “Kërkesa e Veselit” dhe “Vendimi i Kundërshtuar”).² Veseli kërkon të lejohet të përdorë edhe 4.000 fjalë shtesë në apelin që do të dorëzojë, i cili rrjedhimisht nuk do të jetë më shumë se 13.000 fjalë.³ Njëkohësisht, Paneli ka marrë në shqyrtim edhe kërkesën e përbashkët të parashtruar nga Krasniqi, Selimi dhe Thaçi, me anë të së cilës kërkohet tejkalim i ngjashëm i numrit të lejuar të fjalëve për apelet e tyre të ardhshme kundër Vendimit të Kundërshtuar (“Kërkesa e Krasniqit, Selimit dhe Thaçit”)⁴ (bashkërisht, “Mbrojtja” dhe “Kërkesat”).

1. Paneli vëren se neni 46(3) i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)⁵ përcakton që apelet e ndërmjetme kundër vendimeve mbi mocionet paraprake të parashtruara në bazë të rregullës 97(3) të Rregullores nuk duhet të jenë më shumë se 9.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton që pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë, paraprakisht dhe duke lejuar kohë të mjaftueshme,

¹ F00008, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit për Shqyrtimin e Kërkesave në lidhje me Numrin e lejuar të Fjalëve, 17 gusht 2021.

² F00006, Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Numrit të lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021 (“Kërkesa e Veselit”); F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

³ Kërkesa e Veselit, para. 2.

⁴ F00007, Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit, Selimit dhe Thaçit për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021 (“Kërkesa e Krasniqit, Selimit dhe Thaçit”).

⁵ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, në rast se provojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme.⁶

2. Veseli parashtron se Paneli e zgjati afatin për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar deri më 27 gusht 2021 dhe se kërkesa e tij është parashtruar në kohë, “afërsisht rreth gjysmës së afatit të mbetur për parashtrimin e apelit”.⁷ Megjithëse Krasniqi, Selimi dhe Thaçi nuk trajtojnë kohën e dorëzimit të parashtrimeve të tyre, Paneli është bindur se Kërkesat, të parashtruara më 16 gusht 2021, janë dorëzuar mjaftueshëm për para përfundimit të afatit.

3. Veseli gjithashtu argumenton se janë dhënë arsye të vlefshme për miratimin e kërkesës së tij duke mbajtur parasysh numrin, kompleksitetin dhe risinë e çështjeve që do të trajtohen.⁸ Ai më tej parashtron se rrethanat e posaçme demonstrohen nga fakti se në Vendimin e Kundërshtuar trajtohen çështje të rëndësishme juridike dhe se vendimi që do të marrë Paneli do të krijojë precedent mbi të cilin do të mbështeten çështje gjyqësore të tjera në të ardhmen.⁹ Krasniqi, Selimi dhe Thaçi theksojnë rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjeve që trajtohen në Vendimin e Kundërshtuar, veçanërisht lidhur me konceptin e ndërmarrjes kriminale të përbashkët, dhe nënvizojnë nevojën për kryerjen e një analize thelbësore të çështjeve në fjalë, pasi ato nuk janë trajtuar më parë nga Paneli.¹⁰

4. Paneli mban parasysh gjatësinë e Vendimit të Kundërshtuar (gjithsej 98 faqe). Gjithashtu, Paneli mban parasysh faktin se Gjykatësi i Procedurës Parapake ka miratuar edhe më parë tejkalim të numrit të lejuar të fjalëve për parashtrime në lidhje

⁶ Shih p.sh. F00285, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjet, 7 maj 2021 (“Vendimi mbi Numrin e Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjet”), para. 6.

⁷ Kërkesa e Veselit, para. 7.

⁸ Kërkesa e Veselit, para. 8.

⁹ Kërkesa e Veselit, para. 6.

¹⁰ Kërkesa e Krasniqit, Selimit dhe Thaçit, para. 10-11.

me mocionet paraprake mbi juridiksionin.¹¹ Në një vendim të mëparshëm, Paneli pranoi se rëndësia dhe kompleksiteti i çështjeve të ngritura në Vendimin e Kundërshtuar, si dhe risia që ato paraqesin përpara Panelit të Gjykatës së Apelit, përbënin arsye të vlefshme, në atë rast, për ndryshimin e afatit për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar deri më 27 gusht 2021.¹²

5. Paneli vlerëson se cilësia dhe efektshmëria e apeleve nuk varet nga gjatësia e tyre por nga qartësia dhe logjika e argumenteve të paraqitura, dhe, për pasojë, apelet e stërgjata nuk i shërbejnë synimit të administrimit të efektshëm të drejtësisë.¹³ Megjithatë, Paneli konstaton se për shkak të rëndësisë së apeleve kundër vendimeve mbi mocionet paraprake lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara, mund të jetë me vlerë që Paneli të marrë parashtrime më të hollësishme se ato që lejohen normalisht, çka përlligjë devijimin nga afatet dhe numri i lejuar i fjalëve të përcaktuara përkatësisht në Rregullore dhe në Udhëzuesin e Punës.¹⁴ Lidhur me këtë, Paneli rikujton konstatimin e vet të mëparshëm se është në interes të drejtësisë që palët që paraqiten para Dhomave të Specializuara të mund të dorëzojnë apele kuptimplota në lidhje me pikat e ngritura në Vendimin e Kundërshtuar.¹⁵ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme dhe se tejkalimi i numrit të lejuar të fjalëve përlligjet. Gjithashtu, Paneli vlerëson se kërkesa për

¹¹ F00190/CONF/RED, Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Kërkesën e Dytë të Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesën e Re për Masa Mbrojtëse dhe Çështje Procedurale, 5 shkurt 2021 (konfidencial, versioni origjinal i dorëzuar më 5 shkurt 2021), para. 141-142, 144(m); F00250, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Tejkallimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 prill 2021, para. 6-7; Vendimi mbi Numrin e Lejuar të Fjalëve për Kundërpërgjigjet, para. 7-8. Shih gjithashtu Kërkesën e Krasniqit, Selimit dhe Thaçit, para. 12.

¹² F00005, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, 28 korrik 2021 ("Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve"), para. 5.

¹³ Shih p.sh. IRMCT, *Prosecutor v. Karadžić*, MICT-13-55-A, Decision on a Motion for an Extension of a Word Limit, 8 September 2016, p. 2; ICTY, *Prosecutor v. Hartmann*, IT-02-54-R77.5-A, Decision on Motions to Strike and Requests to Exceed Word Limit, 6 November 2009, para. 23.

¹⁴ Shih p.sh. STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01-PT/TC, Decision on Extension of Word Limits for the Filing of Preliminary Motions Challenging Jurisdiction, 8 May 2012, para. 13.

¹⁵ Vendimi mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, para. 5.

përdorimin e 4.000 fjalëve shtesë, deri në jo më shumë se gjithsej 13.000 fjalë, është e arsyeshme në këto rrethana.

6. Paneli vëren parashtrimin e Mbrojtjes se Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") nuk i kundërshton Kërkesat.¹⁶ Paneli rikujton se, bazuar në nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, mocionet për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohen pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për t'u shprehur në lidhje me mocionin. Duke mbajtur parasysh afatin e ardhshëm për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar, si edhe parashtrimin e Mbrojtjes se ZPS-ja nuk i kundërshton Kërkesat,¹⁷ Paneli është bindur se nuk do t'i shkaktohet asnjë dëm palës kundërshtare. Për rrjedhojë, Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë që të merret vendim i menjëhershëm lidhur me Kërkesat.

7. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesat; dhe

AUTORIZON secilin prej të akuzuarve që deri më 27 gusht 2021, të dorëzojë apelin e vet me jo më shumë se 13.000 fjalë.

_____/nënshkrimi/_____

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E enjte, 19 gusht 2021

Në Hagë, Holandë

¹⁶ Kërkesa e Veselit, para. 3, 7. Veseli parashtron se më 14 gusht 2021, Mbrojtja kërkoi miratimin e ZPS-së për tejkalimin e kërkuar të numrit të fjalëve dhe se më 15 gusht 2021 mori përgjigjen e ZPS-së lidhur me këtë. Shih gjithashtu Kërkesën e Krasniqit, Selimit dhe Thaçit, para. 12.

¹⁷ Po aty. Veseli gjithashtu thekson se që tani jep pëlqimin e vet në qoftë se ZPS-ja dëshiron të ketë një ndryshim të ngjashëm dhe proporcional të numrit të lejuar të fjalëve për përgjigjen e saj; shih Kërkesën e Veselit, para. 9.